

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: “Spitali Regjional -Prizren”	Kopje:	Paneli Shqyrtues – OSHP Nr. 117/17.
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues Agon Hoti-Ekspert Teknik		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën “Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik” , me nr. të Prokurimit: 70010/17/172/121/04		
Përgjigjeje në ankesë:	OE- “Uni-Care”-sh.p.k		
Datë	12.05.2017		


Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga OE: OE- **“Uni-Care”sh.p.k**, kundër AK – Spitali Regjional-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik”** me nr. të Prokurimit: **70010/17/172/121/04**.

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

- 1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
- 1x1 Autoriteti Kontraktues.
- 1x1 Operatorit ekonomik ankues.

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: **“Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik”**, me nr. të Prokurimit: **70010/17/172/121/04**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –**Spitali Regjional-Prizren.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

	02.05.2017	03.05.2017	12.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të eksp.	Data e fillimit të ekspertizës	Data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 20.04.2017, OSHP, ka pranuar ankesën me nr. 117/17, e parashtruar nga OE: **“Uni-Care” sh.p.k**, kundër AK – Spitali Regjional-Prizren, lidhur me aktivitetin të prokurimit **“Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik”** me nr. të Prokurimit: **70010/17/172/121**.

Konform nenit 113.1, të LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues-teknik e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – Spitali Regjional-Prizren.

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues “Uni-Care”-sh.p.k

Pikat e Ankesës nga OE “Uni-Care”sh.p.k.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Bazuar në dosjen e tenderit dhe në Ligjit të Prokurimit Publik 04-L042. Neni S2. Pika 1. Autoriteti kontraktues është përcaktuar që kriter për dhënjën e kontratës është “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Ne mendojmë se Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik 04-L042 (LPP 04-L042), Neni-t 6, Pikës 1; dhe me këtë rast fondet publike i tenton t'i shpërdoroj drastikisht duke eliminuar ofertën tonë e cila është rreth 10'000 Euro më e favorshme se oferta pasuese.

Ne poashtu mendojmë se Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të LPP-04-042. Neni-t 7. Pikës 1 dhe 2, me ç'rast nuk ka bërë trajtim të barabartë dhe transparent në mes operatorëve ekonomik të cilë kanë prezentuar ofertat e tyre në këtë tender, madje në mënyrë të njëanshme eliminon konkurrencën dhe diskriminon në dëm, përkatësisht në të mirë të një operatori ekonomik për qëllime të panjohura për ne.

Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur edhe Pikën 3 të Neni 7, të LPP-04/042 pasi në mënyrë tendencioze dhe me prapavijë dhe pa bazë të vaçantë profesionale ka bërë përcaktimin e specifikacioneve teknike me qëllim që të favorizojë ose diskriminojë një apo më shumë operatorë ekonomik.

Ne konsiderojmë gjithashtu se Autoriteti kontraktues dhe Komisioni Verësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave me këtë rast ka bërë shkelje edhe Neni-t 59 dhe Neni 60, Pikës 1.1. të LPP-04-042.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Arsyet e diskualifikimit të ofertës nga kompania Unicare Sh.P.K, sipas autoritetit kontraktues.

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: **“Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik”**, me nr. të Prokurimit: **70010/17/172/121/04**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Spitali Regjional-Prizren.

Pika 3 - Autoriteti kontraktues thekson se: nuk i plotëson kushtet e kërkuara për shkak të parimit të spektrofotometris

Përgjigje:

Sa i perket kesaj pike, me pergjegjesi të plote deklarojme se oferta jone ne perpikëri e ofron ate cka eshte kerkuar ne specifika nen piken 3. Madje ka edhe avatazhe sa i përket kësaj metodologjie. Fotometria është koncept në të cilën mbështetet puna e analizatoreve biokimike te rangut te larte që për bazë ka “Concave Diffraction Grating” dhe në kuadr të kësaj metodologjie përfshihet spektrofotometria, potenciometria, nefelometria dhe të gjitha metodat tjera biokimike. Në bazë të kësaj ju informojmë se spektrofotimetria është pjesë e fotometrisë prandaj aparatura e ofruar nga kompania ABBOTT përmbanë spektrofotometrinë dhe ka shtesë edhe metodat tjera prandaj si e tillë e plotesën kërkesat e specifikimeve teknike në tenderin tuaj dhe i tejkalon ato në kuptim të një rangu më të gjerë të spektrit optik. Derisa spektrofotometria ka vetëm 13 gjatësi valore për leximin e rezultateve, në aparaturën ABBOTT ka mundësi të lezimit në 16 gjatësi valore (ne 340, 380. 404, 412 444, 476, 500, 524, 548, 572, 604, 628, 660, 700, 748 dhe 804 nm.) prandaj si e tillë është me e avancuar. Kompania Unicare në letrën për informacione shtesë ka sqaruar këtë fakt por autoriteti kontaktues i ka anshkalura sqarimet shtesë.

Prandaj konstatimi i autoritetit kontraktues se aparatura e ofruar nga kompania ABBOTT lidhur me këtë pikë nuk qëndron, është në kundërshtim me konstatimin profesional biokimik dhe për më tepër përparësitë e aparturës biokimike qe ne e ofrojmë tenton që ta përshkruaj si mangësi dhe është në kundërshtim me LPP 04/L042 neni 7 pika 3 (si më lartë).

Pika 4 - Autoriteti kontraktues thekson: Në të gjithë dokumentacionin e ofruar nga ana e juaj ne të dhënat për aparatin në fjalë nuk kemi gjetur memorizim me të lartë se 50.000 | teste, kërkesajone eshte per 100.000 mostra

Përgjigje:

Apartura e ofruar nga kompania Unicare plotëson kushtin e memorizimit deri në 300.000. Kjo arrihet me sistemin kompjuterik aktual ndërsa broshura i takon periudhës para më shumë se 5 vite ku memorizimi me sistemin Pentium 4 ka qene në 93000 mostra. Për ti kujtuar autoritetit kontraktues sistemi i tillë kompjuterik Pentium IV nuk ekziston që disa vite dhe sistemet e reja të sofwerit mundësojnë arhivimin deri 300.000 mostra.

Prandaj kompania Unicare deklaron se aparatura e ofruar memorizon deri në 300.000 mostra dhe e tejkalon kërkesat e specifikacioneve në tender dokument.

Pika 10 Autoriteti kontraktues thekson: në as një dokumentacion të ofruar nga ana e juaj nuk kemi gjetur se aparatura e tillë disponon me kiveta kuarci por ekzistojnë kiveta të qelqit.

Apartura e ofruar nga kompania Unicare ka kiveta kuarci dhe deklarojmë edhe një here se këto kiveta do të ju ofrohen nga kuarci.

Konstatimi i autoritetit kontraktues edhe një here vë në pah konstatim të padituri së profesionale dhe nuk merre parasysh sqarimet plotësuese të personave përgjegjës të kompanisë ABBOTT.

Për njohurin tuaj.ju lutem gjeni një sqarim të personave profesional të fushës së biokimisë:

Disa analizatore ne vehte inkorporojne kiveta plastike e qe duhet te nderrohen kohe pas kohe dhe me se largu çdo gjashte muaj. Duke pasur parasysh qe cmimi i ketyre kivetave eshte relativishi i larte si dhe jostabil e kuptojme nevojën për kiveta permanente të cilat parimisht nuk do të duhej të nderroreshin. Mirepo ne anen tjetër, materiali Kuarc është poashtu një lloj qelqi sikurse edhe Boraksi, Pyrexii etj. Te gjitha keto me një emer quhen qelq. Tash, te argumentohet nga ana e komisionit qe ne kemi kerkuar kiveta kuarcit dhe ju na keni ofruar kiveta qelqi eshte i pakuptimte. Ne nuk e kuptojme argumentin e komisionit per kete pike sepse vet komisioni nuk e ka dhene shpjegimin me argumente shkencore pse insistojne ne kiveta kuarcit ndaj atyre nga qelqi, duke theksuar se nuk ka kiveta të qelqit klasik po ka kiveta të materialet permanent si më lartë (Kuarci, Boraksi, Pyrexii).

4. Në letrën e dërguar nga ana juaj për sqarime shtesë në lidhje me pikën "kapacitetet teknike dhe profesionale" të dates 27.03.2017 ju keni vënë në dyshim përmbajtjen dhe Autorizimit nga prodhuesi për pjesëmarrje në këtë tender.

Përgjigje:

Ne edhe për këtë pike konsiderojmë se vlerësimi juaj është tejet tendencioz me prapavijë të qëllimshme sepse ky dokument original ka ardhur drejtëpërdrejtë nga prodhuesi dhe i adresohet Spitalit Regjional të Prizrenin me qëllim të pjesëmarrjes në tenderin " Furnizim me aparat analajzer biokimik automatik" dhe përshkruhet qartë se autorizohet kompania jonë për të aplikuar në këtë tender duke respektuar të gjitha kërkesat që dalin nga ky dokument përfshirë kërkesën për të dërguar dokumentin, pjesëmarrjen, ankesat, shitjen, nënshkrimin e kontratës për furnizim, servisimi dhe emërmbajtjen e aparaturës dhe të gjitha aktivitetet e tjera të ndërlidhura me këtë proces tenderimi. Për më tepër në dokumentacion gjenden edhe 3 certifica/dëshmi të serviserëve të trajnuar për aparaturën e ofruar përfshirë një certificate të përfaqësuesit kryesor të kompanisë UniCare Sh.P.K. Autorizimi nga prodhuesi gjithashtu i ka të gjitha informtat për kontakt dhe në rast se autoriteti kontraktues ka kërkesa për sqarime të autorizimit ka të drejtën për kontakt dhe sqarime shtesë. Forma e tillë e autorizimit nga kompania ABBOTT Diagnostics na ka përcjellur me shumë se 10 vite nëpër procedura të prokurimit ku ne kemi nënshkruar edhe kontrata me këto autoritete pa ndonjë mangësi në autorizim.

Prandaj konstatim i tillë është i pabazuar, joprofesional dhe lë vend për dyshime në korrektësinë e Autoritetit kontraktues në tenderin në fjalë.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	14.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbime/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas zgjatjes së afatit,	17.03.2017
Afati i parapare për hapje të ofertave, pas zgjatjes,	17.03.2017
Data e njoftimit për dhenje të kontratës	14.02.2017

Kriteret për vlerësim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

KERKESA 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të ligjit për, Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237,

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: "Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik", me nr. të Prokurimit: 70010/17/172/121/04, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Spitali Regjional-Prizren."

ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L- 092 për Prokurimin Publik në Kosovë, gazeta zyrtare Nr.08 të dt.01.03.2016 ,munde te shkarkohet nga faqe e internetit krpp.rks-gov.net

EVIDENCA NGA FITUESI I TENDERIT Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise para shperblimit te kontrates janë me se vijon: -Për situaten referuar nenit 65,paragrafi3 ,nenparagrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4,nen-paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.4,vertetim i leshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative te vendit te themelimit te tenderuesit.

4.-Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore e vendit te themelimit te operatorit ekonomik ,se operatori ekonomik ne fjale nuk eshte delikuent (shkeles)ne pagesen e tatimeve se paku deri ne tremujorin e fundit te vitit para dates se publikimit te Njoftimit te Kontrates. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

EVIDENCA 1. Nje deklarata e shkruar nen Betim,e nenshkruar nga tenderuesi duke perdorur formen e percaktuar ne dosjen e tenderit. Per qdo OE nese jane Grup i OE **EVIDENCA NGA FITUESI I TENDERIT** Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise para shperblimit te kontrates janë me se vijon: -Për situaten referuar nenit 65,paragrafi3 ,nenparagrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4,nen-paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.4,vertetim i leshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative te vendit te themelimit te tenderuesi

Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore e vendit te themelimit te operatorit ekonomik ,se operatori ekonomik ne fjale nuk eshte delikuent (shkeles)ne pagesen e tatimeve se paku deri ne tremujorin e fundit te vitit para dates se publikimit te Njoftimit te Kontrates. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

KERKESA. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik.

KERKESA . Regjistrimi i TVSH.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

EVIDENCA Nje dokument leshuar nga autoriteti perkates publik ne vendin e themelimit te operatorit ekonomik mete cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik ne ate vend (Kopja e certifikates se biznesit)– per qdo OE nese jane Grup i OE **EVIDENCA** Kopja e TVSH-se –per qdo OE nese jane Grup i OE

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare: **KERKESA - Katalogu per Aparatin e ofruara me te dhenat teknike qe te behet krahasimi mes aparateit te ofruara dhe te kerkuara (te jene te nenvizuara ato specifikime te cilat ofrohen**

KERKESA - Paisje per nga kualiteti kerkohet te jene te qertifikuar sipas standardeve ISO –CE

KERKESA - Autorizimi per shitje dhe servisim nga prodhuesi ose dileri i auautorizuar per paisjen e ofruar.

KERKESA – Certifikat si deshmi që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin per aparatin e kërkuar
 Një dëshmi mbi realizimin e furnizimeve të ngjashme
 OE ne oferten e tij duhet te perfshij manualin per perdorim të aparatit së bashku me CD për instalim te testeve dhe riinstalim të programi

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca - Katalogu per paisjen e ofruara specifikacioni te perputhet me katalog, ne katalog te nenvizohen specifikat e aparatit te ofruar

Evidenca - ISO Certifikat.,CE Certifikat

Evidenca - Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar per shitje dhe servisim – Original apo të (Noterizuara)

Evidenca - Certifikat si deshmi që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin per aparatin e ofruara
 OE duhet te deshmoj ne oferten e tij sëpaku 1 (një) referenc ose raporti mbi kryerjen e furnizimeve të ngjashme

Evidenca- Manuali dhe CD-ja.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €
1.	“Biotek Kosovo”	Prishtinë	48,000.00€
2.	“Keis (Kosova ex.imp.supply Pharmaceut) sh.p.k	Prishtinë	64,664.00€
3.	N.T.P “Buli”-Medical	Prishtinë	59,841.00€
4	“Uni-Care”-sh.p.k	Prishtinë	38,700.00€
5	“Interlab”-sh.p.k	Daridove	58,888.00€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 17.03.2017, konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë pesë (5) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Në procesverbali të hapjes NUK është rexhistruar ndonjë vërejtje për hapjen e ofertave.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit –Burim VEHAPI
- - Anëtar i komisionit - Sadri BEQIRI
- - Anëtar i komisionit – Vedat SELMANI

Data e mbarimit të vlerësimit:12.04.2017

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: “Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik”, me nr. të Prokurimit: 70010/17/172/121/04, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Spitali Regjional-Prizren.’

Raporti i komisionit vlerësues:

Pas kontrollimit dhe vlerësimit të dokumentacionit komisioni i vlerësimit Dr.Burim Vehapi,Dr.Sadri Beqir dhe Vedat Selmani, u dakordua që fitues i tenderit të shpallet IE BIOTEK KOSOVO LLC, për shumën 48,000.00€, pasi që i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara sipas dosjes së tenderit.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - (N. 306) :

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1. Autoriteti Kontraktues - “Spitali Regjional PRIZREN”, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: “Uni care”sh.p.k, ka parashtruar ankesë kundër arsytimit të eliminimit të shprehur në letër standarde të datës **29.03.2017**, ku AK-ja, ka shpallur të papërgjegjshëm OE ankues në lidhje me specifikimin teknik, në lidhje me kërkesat e FDT-së, sa i përket pikës 3,4 dhe 10 si dhe sa i përket kërkesës së autorizimit të prodhuesit.

Në lidhje me pretendimet ankimore të parashtruar nga ana e OE ankues, Eksperti Teknik jep vlerësimin si në vijim:

PIKA 3. Eksperti teknik vlerëson se OE ankues ka te drejt sa i perket parimit te Spektrofotometris. Duke e ditur qe Spektrofotometria është pjesë e Fotometris ne te cilen mbulohet edhe Potenciometria e Nefelometria mund të themi se Analajzeri Biokimik Automatic I ofruar nga OE I ashtuquajtur i Architect c8000 perfshin parim Spektrofotometrik dhe ate me gjatësi valore prej 340-804 nm.

Sqarime shtes te marrurra nga prodhuesi:

- Metoda e matjes fotometrike, ose fotometria, është një teknikë që mund të përdoret për të matur përqendrimin e komponimeve organike dhe inorganike në zgjidhje duke përcaktuar absorbimin e gjatësisë së valëve specifike të dritës. Të gjitha metodat e matjes fotometrike bazohen në të njëjtin parim.

Spektrofotometria është fotometri, bazuar në metodën e barazimit të barabartë të absorbimit të dritës, të gjitha të bazuara në parimet fizike të Lambert-Beer (lidhja lineare midis absorbimit dhe përqendrimit të një lloji absorbues).

Pika 4. Eksperti teknik vlerëson se OE ka te drejt sa i perket memorizimit te aparatures Abbott c8000.

Ne bazë te shqyrtimit te dosjes se OE dhe ne bazë te sqarimeve nga ana e prodhuesit konstatojm se sistemi I Architect c8000 tejkalon memorizimin e te dhenave te pacienteve ne database mbi 100 000 mostra, dhe ate duke shtuar si pjes integrale me memorizim 2 TB.

Sqarimet shtes te marrura nga prodhuesi :

- Stemi i Arkitektit ka modalitetin e ruajtjes së më shumë se 100.000 mostrave të pacientëve.

Pika 10. Eksperti teknik vlerëson se OE ka te drejt rreth qendrimit te materialit qelq-kuarc-plastik.

Ne bazë të studimit te lëndës së analajzerit te ofruar nga OE konstatojm se Architect c8000 punon me kiveta Kuarci.

Sqarim skencor nëse është I nevojshëm rreth materialit kuarc dhe qelq:

<http://ëëë.fireflysci.com/neës/2015/7/6/hoë-to-select-cuvettes-for-uv-vis-measurements-cuvette-material-guide>

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: “Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik”, me nr. të Prokurimit: 70010/17/172/121/04, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Spitali Regjional-Prizren.

Sqarimi i ofruar nga prodhuesi:

Materiali i kuarcit është lloji i qelqit. Arkitekt c8000 përdor cuvettes kuarc.

Eksperti shqyrtues-teknik, vlerëson se OE ankues në lidhje me autorizimin e dorëzuar nga prodhuesit, NUK ka ofruar autorizim sipas kërkesës së FDT-së siç është kërkuar: “Autorizim për shitje dhe servisim”, Poashtu në harmoni me nenin 72 të LPP-së AK-ja ka kërkuar s’qarim shtesë në lidhje me autorizimin për shitje nga ana e OE ankues, ndërsa i njëjti OE ankues NUK ka arritur të ofroj dëshmi shtesë brenda afatit kohor të kërkuar nga ana e AK-së në lidhje me autorizimin prodhuesit dhe i njëjti për këtë pikë është i papërgjegjshëm.

Mendimi i ekspertit:

Eksperti shqyrtues-teknik, bazuar në s’qarimet e cekura më lartë në raport mendon që Autoriteti Kontraktues – **Spitali Regjional Prizren**, për këtë aktivitet të prokurimit: “**Furnizim me aparat analajzer biokimik-automatik**”, me nr. të Prokurimit: **70010/17/172/121**, REKOMANDON, panelit shqyrtues që të APROVOJ vendimin e AK-së, njoftimin për dhënje të kontratës të datës 14.02.2017. ndërsa ankesa e OE “**Uni Care**” shpk, të aprovohën si **pjesërisht e bazuar**.